



01 Nr. 014/25 Dt. 14.01.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 3 paragrafi 4 dhe nenit 14 paragrafi 1.4 Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, Marrëveshjes së Sponsorizimit të nënshkruar ndërmjet Shoqatës “Aces Europe” me qendër në Bruksel (Belgjikë) dhe Komunës së Prizrenit, datë 17.12.2024, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Me këtë Vendim lejohen mjetet financiare për pagesë të faturës nr. 1442024 të Shoqatës “Aces Europe” (Shoqatë e cila promovon politika sportive evropiane përmes ndarjes së çmimeve ndërkombëtare si Kryeqytet Evropian) me qendër në Bruksel (Belgjikë), e cila është faturuar konform Marrëveshjes së Sponsorizimit të nënshkruar ndërmjet Shoqatës “Aces Europe” me qendër në Bruksel (Belgjikë) dhe Komunës së Prizrenit, datë 17.12.2024, e që ka për qëllim aplikimin Komunës së Prizrenit për “City of Sports 2026”, andaj, për këtë qëllim lejohen mjetet financiare në shumën prej 2.350,00 € (dymijë e treqind e pesëdhjetë euro).
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Marrëveshja e Sponsorizimit të nënshkruar ndërmjet Shoqatës “Aces Europe” dhe Komunës së Prizrenit, datë 17.12.2024.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.
4. Mjetet e lartcekura, si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të alokohen (bëhet pagesa) në xhironlogarinë nr. –IBAN: BE51 0018 5806 0662 BIC: GEBABEBB, Aces Rond Pount Robert Schuman, 6 Box 5. 1040-Brusswl, BE0831576545, Belgium.
5. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.

